



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 128, Datë 31.05.2022

MBI

**REFUZIMIN PËRLICENCIMIN E SHOQËRISË “GREEN ENERGY BILISHT”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar;si dhe nenit 14, pika 1 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; dhe nenit 15, gërma “a” të Rregullore për Organizimin, funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 830/8 prot., datë 27.05.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik 2 MW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Green Energy Bilisht” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 448 prot., datë 04.04.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga Centrali Fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 80, datë 13.04.2022, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW.
- Me shkresën nr. 448/1 prot., datë 21.04.2022 shoqëria është njoftuar për të plotësuar dokumentacionin e munguar sipas nenit 9, pika 2, gërmat “a”, “d”, “f”; nenit 9, pika 3, gërmat “b”, “c”; neni 9, pika 4.1.4; neni 9, pika 4.4.5.

- Shoqëria nuk ka plotësuar dokumentacionin e munguar dhe në zbatim të nenit 14, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, *bordi i ERE-s e merr vendimin perfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike brenda 60 ditëve pune nga data e publikimit të parë në shtyp të njoftimit për aplikimin në shtyp.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të refuzojë licencimin e shoqërisë “GREEN ENERGY BILISHT” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.